



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 457 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 76 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Propozimin teknik të projektit të zhvendosjes së një segmenti të linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë, nga shtylla 49 deri te shtylla 59*, paraqitur nga OST Sh.p.k.

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Propozimin teknik të projektit të zhvendosjes së një segmenti të linjës së transmetimit 400kv Shqipëri-Kosovë, nga shtylla 49 deri te shtylla 59*, paraqitur nga OST Sh.p.k.
- II. Të realizohen sondazhe arkeologjike nga një shoqëri arkeologjike e licencuar për veprimtari arkeologjike, për shtyllat nga 49 deri te 59, të segmentit të linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë, të cilat pozicionohen brenda zonës arkeologjike "B" të propozuar të Komanit.
- III. Të lidhet aktmarrëveshje trepalëshe ndërmjet Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, OST, dhe shoqëri arkeologjike e licencuar për veprimtari arkeologjike, në lidhje me sondazhet që do të kryhen në zonën arkeologjike "B" të propozuar, të Komanit. Raporti i tyre të paraqitet në KKA.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO